REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASENIT UJOR ISHËM**

**VENDIM**

Nr.**5**, datë **9/02/2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR PËR NDËRTIMIN, RINDËRTIMIN, APO SHEMBJEN PËR MBROJTJEN E BRIGJEVE, MUREVE, PRITAVE E VEPRAVE TË TJERA NË BRIGJE PËR PROJEKTIN, "SISTEMIM I PJESSHËM I LUMIT LANA" ME VENDNDODHJE BASHKIA TIRANË, SUBJEKTI "BASHKIA TIRANË"**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50,të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës së subjektit "Bashkia Tiranë" për autorizim për përdorimin e burimit ujor për ndërtimin, rindërtimin, apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje për projektin, "Sistemim i pjesshëm i lumit Lana" me vendndodhje Bashkia Tiranë.

2. Vendodhja e strukturave që do të ndërtohen (koordinatat KRGJSH).

1.X-480217.731; Y-4578575.725; Z-70.15 m.m.n.d;
2.X-480210.787; Y-4578555.341; Z-70.20 m.m.n.d;
3.X-480269.643; Y-4578564.469; Z-70.20 m.m.n.d;
4.X-480280.283; Y-4578547.109; Z-70.15 m.m.n.d;
5.X-480300.891; Y-4578613.189; Z-70.20 m.m.n.d;
6.X-480309.067; Y-4578595.717; Z-71.00 m.m.n.d;
7.X-480429.159; Y-4578614.309; Z-71.20 m.m.n.d;
8.X-480437.895; Y-4578592.805; Z-71.50 m.m.n.d;
9.X-480444.566; Y-4578620.609; Z-69.60 m.m.n.d;
10.X-480444.230; Y-4578596.193; Z-71.30 m.m.n.d;
11.X-480490.500; Y-4578592.440; Z-71.80 m.m.n.d;
12.X-480474.932; Y-4578572.392; Z-71.80 m.m.n.d;

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR
ISHËM